



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 490B/2010

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), Ferit Osmani Kryesues i panelit, duke vendosur përkritazi për kërkesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosja (LVV) me seli në Prishtinë, paraqitur kundër vendimit Anr. 490B/2010 datë 16.12.2010, për shkak se nuk korrespondon numri i vendimit me numrin e ankesës, me datën 28.12.2010 mori kete;

V E N D I M

PËRMIRSOHET kopja e dhënë e ankesës subjektit politik Lëvizja Vetëvendosja (LVV) me Anr. 491/2010 datë 13.12.2010, ashtu që duhet të jetë Anr. 490B/2010 datë 13.12.2010.

A r s y e t i m

PZAP-i ka pranuar një kërkesës nga subjekti politik LVV më Anr. 670/2010 datë 17.12.2009, më të cilën ka kërkuar korrigjimin e vendimit Anr. 491/2010 datë 16.12.2010 me propozim për dhënien e vendimit sipas përmbajtjes së ankesës.

PZAP-i, pas vlerësimit të kërkesës dhe propozimit të palës ankuese, shikimit të vendimit Anr. 490B/2010 dt 16.12.2010, ka konstatuar se është bërë gabim teknik, me rastin e kopjes së fletës së parë të ankesës më nr. 491 dt. 16.12.2010 të dhënë subjektit politik LVV, ashtu që duhet të jetë Anr. 490B/2010..

Andaj duke marrë parasysh një lëshim të tillë, PZAP-i ka marr vendim si në dispozitiv, konform nenit 165.1 të LPK në lidhje me nenin 165.3 të LPK.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Anr. 490B/2010 datë 28.12.2010

Kryesuesi i Panelit

Ferit Osmani

